



UKKO Nr 3/4 prot
N.06.03.2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A
ASAMBLEJA E AKSIONAREVE

Nr. 1691 prot.
12

Korçë, më 06.03.2023

V E N D I M

Nr. 3 datë 06 .03.2023

P Ë R

MIRATIMIN E PRISHJES SË SHOQËRISË, E FILLIMIT TË PROCEDURËS SË
LIKUIDIMIT DHE EMËRIMIN E LIKUIDUESIT

Sot, më datë 06 Mars 2023, Shoqëria Ujësjiellës Kanalizimeve Korçë Sh.A (UKKO SH.A), një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, me kodin unik NIPT J641031410 mbajti mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve. Mbledhja u thirr nga administratori i shoqërisë zoti Pandi Qirinxhi për të diskutuar **ndër të tjera , mbi çështjet e rendit të ditës si vijon:**

- Prishja e Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizimeve Korçë Sh.A. dhe shpallja e saj në likuidim;
- Emërimi i Likuidatorit.

Në shqyrtim të çështjeve të mësipërme të rendit të ditës, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve vëren:

Shoqëria Ujësjiellës Kanalizimeve Korçë Sh.A. nuk zhvillon më aktivitete pasi në përputhje me VKM Nr. 302, datë 11.5.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe me Marrëveshjen noteriale të Transferimit të veprimtarisë ekonomike Nr. repertori: 5232, nr. koleksioni: 3520, datë 12.09.2022, të ndryshuar me Amendament kontratën noteriale datë 06.03.2023, të lidhur midis Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizimeve Korçë Sh.A. dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizimeve Korçë Sh.A., kjo shoqëri e ka transferuar veprimtarinë ekonomike si dhe aktivet dhe detyrimet e saj në tërësi. Nga data 01.01.2023, kjo shoqëri nuk ka më të drejtë të zhvillojë aktivitetin për të cilin ajo është themeluar.

Për sa konstatohet më sipër, shoqëria e ka përmbushur qëllimin e krijimit dhe nuk ka më arsye të vijojë ekzistencën e saj dhe duhet të priset dhe të çregjistrohet nga regjistri tregtar QKB.

Pasi diskutoi gjerësisht mbi çështjet më sipër të rendit të ditës, Aksionari i Vetëm

V E N D O S I :

1. Përfundimin e aktivitetit të Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizimeve Korçë Sh.A. dhe prishjen e saj.
2. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizimeve Korçë Sh.A shpall hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese.
3. Emërimin e Z. Pandi Qirinxi si likuidator të Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizimeve Korçë Sh.A.
4. Likuidatori autorizohet të përgatisë Raportin Përfundimtar të Likuidimit të shoqërisë. Ai gjithashtu autorizohet të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për likudimin e shoqërisë si dhe të kërkojë, paraqesë çdo dokument të nevojshëm pranë autoriteteve private dhe publike në lidhje me likudimin e shoqërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E AKSIONAREVE TË UKKO SH.A

SOTIRAQ FILO

